



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.111

18 tetor

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Dekret nr.5042 datë 3.10.2006	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	4349
Dekret nr.5066 datë 10.10.2006	Për lirim ambasadori.....	4350
Dekret nr.5067 datë 10.10.2006	Për emërim ambasadori.....	4350
Dekret nr.5068 datë 10.10.2006	Për emërim ambasadori.....	4351
Dekret nr.5086 datë 13.10.2006	Për mosmiratimin e propozimit të Kuvendit të Republikës për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm.....	4351
Vendim i KM nr.656, datë 27.9.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.95, datë 13.2.2003 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin në qarqe të drejtorive rajonale të bujqësisë dhe të ushqimit”.....	4352
Vendim i KM nr.657, datë 27.9.2006	Për miratimin e protokollit të katërt shtesë të Kushtetutës së Bashkimit Postar të Përbotshëm, Uashington, 1989.....	4352
Vendim i KM nr.658, datë 27.9.2006	Për miratimin e akteve dhe të dokumenteve kryesore të Kongresit XXIII të Bashkimit Postar të Përbotshëm, Bukuresht, 2004.....	4356

Vendim i KM nr.662, datë 4.10.2006	Për heqjen nga armatimi e përdorimi i një pjese të mjeteve luftarake të aviacionit të Forcave të Armatosura, si dhe për asgjësimin ose çmontimin e shitjen e tyre.....	4356
Vendim i KM nr.671, datë 27.9.2006	Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike, “Justicia”.....	4358
Vendim i GJK nr.23, datë 5.10.2006	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.868, datë 2.12.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit), si të papajtueshëm me Kushtetutën.....	4359
Udhëzim i KQZ nr.6, datë 5.10.2006	Për procedurat dhe kriteret e akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në KZQV, KQV dhe VNV, nga KZQV-ja, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore	4362
Vendim i KKRT nr.509, datë 29.9.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “Tv Kruja”.....	4368
Vendim i KKRT nr.510, datë 29.9.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “Kristal +”.....	4368
Vendim i KKRT nr.512, datë 29.9.2006	Për zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit televiziv kabllor privat “Tepelena Sat”.....	4369

DEKRET
Nr.5042, datë 3.10.2006

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---|---|
| 1. Melsian Aleks Vala | 20. Ioanna Dhimitër Emmanouilidou |
| 2. Gazmend Jonus Saraçi | 21. Aitena Fatos Çausholli |
| 3. Kerstin Gazmend Saraçi | 22. Valdete Bajram Golemi (Kerçiku) |
| 4. Fatbardha Ramadan Saraçi (Mena) | 23. Geri Sokol Kucaj |
| 5. Çlirim Qemal Lika | 24. Diter Sokol Kucaj |
| 6. Ferdinand Vllasi Duka | 25. Zyhra Haxhi Sheni |
| 7. Ervin Kujtim Muharremi | 26. Anton Dushan Devollaj |
| 8. Lorenc Hiqmet Ruzi | 27. Drita Ram Gilloga |
| 9. Sarah Lorenc Ruzi | 28. Fatos Musa Llapushi |
| 10. Brikena Leka Ruzi (Luçi) | 29. Majlinda Shkëlqim Müller (Musabelliu) |
| 11. Enkeleda Vladimir Dollma (Gurabardhi) | 30. Gentiana Pëllumb Doster (Xhelali) |
| 12. Guida Xhemal Gega | 31. Dardan Alush Prengjoni |
| 13. Gazmend Rexhep Shehi | 32. Leonard Skënder Maloku |
| 14. Eriona Rajmond Lazri | 33. Havzije Shaban Gjoci |
| 15. Vjollca Demir Machka (Meçi) | 34. Deniz Koch |
| 16. Fatmir Hismet Shllaku | 35. Arben Skënder Qelibari |
| 17. Leonora Hysen Troci (Dervishi) | 36. Saimir Isa Bajo |
| 18. Lindita Hasan Daçi | 37. Marcela Petrit Hoßbach (Tabaku) |
| 19. Maria Dhimitrios Emmanouilidou | 38. Kozeta Tefik Holsten (Haxhiu) |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.5066, datë 10.10.2006

PËR LIRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika dh, të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Eduart Sulo, lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiptotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Hungarisë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.5067, datë 10.10.2006

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika dh, dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Florian Nova, emërohet në detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiptotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Hungarisë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.5068, datë 10.10.2006

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika dh, dhe 93 të Kushtetutës me propozim të Kryeministrit

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Spiro Koçi, emërohet në detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Serbisë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.5086, datë 13.10.2006

**PËR MOSMIRATIMIN E PROPOZIMIT TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS PËR
SHKARKIMIN E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje të neneve 93 dhe 149, paragrafi 2, të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Propozimi për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm, i miratuar nga Kuvendi i Republikës me vendimin nr.53, datë 24.7.2006, nuk miratohet.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.656, datë 27.9.2006

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.95, DATË 13.2.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN NË QARQE TË DREJTORIVE RAJONALE TË
BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT”**

Në mbështetje të neneve 95 e 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.95, datë 13.2.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për krijimin, në qarqe, të drejtorive rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit”.

b) Në pikat 1 dhe 2 emërtimi “Drejtorive rajonale të bujqësisë dhe të ushqimit (DRBU)” zëvendësohet me “Drejtorive rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit”.

c) Kudo në vendim emërtimet “Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit” dhe “Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit” zëvendësohen, përkatësisht, me “Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit” dhe “Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”.

2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, e Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.657, datë 27.9.2006

PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË KATËRT SHITESË TË KUSHTETUTËS SË
BASHKIMIT POSTAR TË PËRBOTSHËM, UASHINGTON, 1989

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të katërt shtesë të Kushtetutës së Bashkimit Postar të Përbotshëm, Uashington, 1989.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PROTOKOLLI
I KATËRT SHITESË I KUSHTETUTËS SË BASHKIMIT UNIVERSAL
TË POSTAVE

Përfaqësuesit fuqiplotë të qeverive të vendeve anëtare të Bashkimit Universal të Postave u takuan në një kongres në Uashington, në pajtim me nenin 30 paragrafin 2 të Kushtetutës së Bashkimit Universal të Postave të përfunduar në Vjenë më 10 korrik 1964 dhe miratuan, duke iu nënshtruar ratifikimit, ndryshimet e mëposhtme të kësaj Kushtetute.

Neni 1
(Neni 7 i ndryshuar)
Njësia monetare

Njësia monetare e përdorur në aktet e Bashkimit është njësia e llogarive të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Neni 2
(Neni 11 i ndryshuar)
Aderimi ose pranimi në Bashkim. Procedura

1. Çdo anëtar i Kombeve të Bashkuara mund të aderojë në Bashkim.
2. Çdo vend sovran që nuk është anëtar i Kombeve të Bashkuara mund të kërkojë të pranohet si vend anëtar i Bashkimit.
3. Aderimi ose kërkesa për pranim në Bashkim duhet të përfshijë një deklaratë formale të aderimit në Kushtetutë dhe në aktet detyruese të Bashkimit. Ajo i dërgohet nga qeveria e vendit të interesuar Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare, që njofton për aderimin ose konsultohet me vendet anëtare në lidhje me kërkesën për pranim, sipas rastit.
4. Një vend që nuk është anëtar i Kombeve të Bashkuara mendohet të pranohet si një vend anëtar nëse kërkesa e tij aprovet nga të paktën dy të tretat e vendeve anëtare të Bashkimit. Vendet anëtare që nuk janë përgjigjur brenda një periudhe katërmujore konsiderohen sikur kanë abstenuar.
5. Aderimi ose pranimi si anëtar i njoftohet Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare të qeverive të vendeve anëtare. Ai hyn në fuqi nga data e këtij njoftimi.

Neni 3
(Neni 12 i ndryshuar)
Largimi nga Bashkimi. Procedura

1. Çdo vend anëtar mund të largohet nga Bashkimi me anë të një njoftimi denoncimi të Kushtetutës i bërë nga qeveria e vendit të interesuar drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare dhe prej këtij, qeverive të vendeve anëtare.
2. Largimi nga Bashkimi hyn në fuqi një vit pas ditës në të cilën njoftimi i denoncimit i parashikuar në paragrafin 1 merret nga Drejtori i Përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare.

Neni 4
(Neni 21 ndryshuar)
Shpenzimet e Bashkimit. Kontributet e vendeve anëtare

1. Çdo Kongres cakton shumën maksimale që:
 - a) shpenzimet e Bashkimit mund të arrijnë çdo vit;
 - b) mund të arrijnë shpenzimet në lidhje me organizimin e Kongresit tjetër.
2. Shuma maksimale për shpenzimet e përmendura në paragrafin 1 mund të tejkalohet nëse këtë e kërkojnë rrethanat, me kusht që të respektohen dispozitat përkatëse të rregulloreve të përgjithshme.
3. Shpenzimet e Bashkimit, duke përfshirë sipas rastit shpenzimet e parashikuara në paragrafin 2, mbulohen bashkërisht nga vendet anëtare të Bashkimit. Për këtë qëllim, çdo vend anëtar zgjedh klasën e kontributit në të cilën ai synon të përfshihet. Klasat e kontributeve parashikohen në rregulloret e përgjithshme.
4. Në rastin e aderimit ose pranimi në Bashkim, në bazë të nenit 11, vendi i interesuar zgjedh lirisht klasën e kontributit ku ai dëshiron të vendoset për qëllimet e ndarjes së shpenzimeve të Bashkimit.

Neni 5
(Neni 22 i ndryshuar)
Aktet e Bashkimit

1. Kushtetuta është akti bazë i Bashkimit. Ai përmban rregullat organike të Bashkimit.
2. Rregulloret e përgjithshme pëmbajnë ato dispozita që sigurojnë zbatimin e Kushtetutës dhe veprimtarinë e Bashkimit. Ato janë detyruese për të gjitha vendet anëtare.
3. Konventa Universale Postare dhe rregulloret e saj të detajuara pëmbajnë rregullat që zbatohen në të gjithë shërbimin ndërkombëtar postar dhe dispozitat në lidhje me shërbimin e postimit të letrave. Këto akte janë detyruese për të gjitha vendet anëtare.
4. Marrëveshjet e Bashkimit dhe rregulloret e tyre të detajuara rregullojnë shërbime të ndryshme nga ato të postimit të letrave ndërmjet atyre vendeve anëtare që janë palë në to. Ato janë detyruese vetëm për ato vende.
5. Rregulloret e detajuara, që pëmbajnë rregullat zbatuese të nevojshme për zbatimin e konventave dhe marrëveshjeve, hartohen nga Këshilli Ekzekutiv, duke pasur parasysh vendimet e marra nga Kongresi.
6. Protokollet finale që u shtohen akteve të Bashkimit, të përmendura në paragrafët 3, 4 dhe 5, pëmbajnë rezervat e këtyre akteve.

Neni 6
(Neni 23 i ndryshuar)
Zbatimi i akteve të Bashkimit në territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave është i përgjegjshëm një shtet anëtar

1. Çdo vend mund të deklarojë në çdo kohë që pranimi prej tij i akteve të Bashkimit përfshin të gjitha territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave ai është përgjegjës, ose për disa prej tyre.
2. Deklarata e parashikuar në paragrafin 1 duhet t'i drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare.
3. Çdo vend anëtar mund t'i dërgojë në çdo kohë një njoftim Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare në lidhje me synimin e tij për të denoncuar zbatimin e atyre akteve të Bashkimit në lidhje me të cilat ai ka bërë deklaratën e parashikuar në paragrafin 1. Një njoftim i tillë hyn në fuqi një vit pas datës së marrjes së tij nga Drejtori i Përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare.
4. Deklarimet dhe njoftimet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 3 u komunikohen vendeve anëtare nga Drejtori i Përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare.
5. Paragrafët 1 deri 4 nuk zbatohen për territoret që kanë statusin e një anëtar i Bashkim dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave është i përgjegjshëm një vend anëtar.

Neni 7
(Neni 25 i ndryshuar)
Nënshkrimi, autenticiteti, ratifikimi dhe forma të tjera të aprovimit të akteve të Bashkimit

1. Aktet e Bashkimit që dalin nga Kongresi nënshkruhen nga përfaqësuesit fuqiplotë të vendeve anëtare.
2. Rregulloret e detajuara vërtetohen nga Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Ekzekutiv.
3. Kushtetuta ratifikohet sa më parë të jetë e mundur nga vendet firmëtare.
4. Aprovimi i akteve të Bashkimit, përveç Kushtetutës, rregullohet nga dispozitat kushtetuese të çdo vendi firmëtar.
5. Nëse një vend nuk ratifikon Kushtetutën apo nuk aprovon aktet e tjera që ai i ka nënshkruar, Kushtetuta dhe aktet e tjera nuk janë më pak të vlefshme për vendet e tjera që i kanë ratifikuar apo aprovuar ato.

Neni 8
(Neni 26 i ndryshuar)

Njoftimi i ratifikimeve dhe formave të tjera të aprovimit të akteve të Bashkimit

Instrumentet e ratifikimit të Kushtetutës dhe protokollet shtesë të saj, dhe, sipas rastit, të aprovimit të akteve të tjera të Bashkimit depozitohen sa më parë të jetë e mundur te Drejtori i Përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare, i cili njofton qeveritë e vendeve anëtare për depozitimin e tyre.

Neni 9

Njoftimi i aderimit në protokollet shtesë të Kushtetutës së Bashkimit Universal Postar

Nga hyrja në fuqi e akteve të Kongresit të Uashingtonit të vitit 1989, instrumentet e aderimit në Protokollin Shtesë të Tokios të vitit 1969, në protokollin e dytë shtesë të Lozanës e vitit 1974 dhe në protokollin e tretë shtesë të Hamburgut të vitit 1984 i dërgohen Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare që njofton qeveritë e vendeve anëtare për depozitimin e tyre.

Neni 10

Aderimi në protokollin shtesë dhe në aktet e tjera të Bashkimit

1. Vendet anëtare që nuk e kanë nënshkruar këtë protokoll, mund të aderojnë në të në çdo kohë.
2. Vendet anëtare që janë palë në aktet e rinovuara nga Kongresi, por që nuk i kanë nënshkruar ato, aderojnë në to sa më parë të jetë e mundur.
3. Instrumentet e aderimit në lidhje me rastet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2 i dërgohen Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Ndërkombëtare, i cili njofton qeveritë e vendeve anëtare për depozitimet e tyre.

Neni 11

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e protokollit shtesë të Kushtetutës së Bashkimit Universal të Postave

Ky protokoll shtesë hyn në fuqi më 1 janar 1991 dhe mbetet në fuqi për një afat të pacaktuar. Si dëshmi të kësaj, përfaqësuesit fuqiplotë të qeverive të vendeve anëtare kanë hartuar këtë protokoll shtesë, që ka të njëjtën fuqi dhe të njëjtën vlefshmëri sikur dispozitat e tij të ishin përfshirë në tekstin e vetë Kushtetutës, dhe ata e kanë nënshkruar atë në një origjinal të vetëm që depozitohet te Drejtori i Përgjithshëm i Byrosë Ndërkombëtare. Një kopje e saj i dorëzohet çdo pale nga qeveritë e vendit në të cilin mbahet Kongresi.

Bërë në Uashington, 14 dhjetor 1989.

VENDIM
Nr.658, datë 27.9.2006

PËR MIRATIMIN E AKTEVE DHE TË DOKUMENTEVE KRYESORE TË KONGRESIT XXIII TË BASHKIMIT POSTAR TË PËRBOTSHËM, BUKURESHT, 2004

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e akteve dhe të dokumenteve kryesore të Kongresit XXIII të Bashkimit Postar të

Përbotshëm, Bukuresht, 2004.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.662, datë 4.10.2006

**PËR HEQJEN NGA ARMATIMI E PËRDORIMI I NJË PJESE TË MJETEVE LUFTARAKE
TË AVIACIONIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA, SI DHE PËR ASGJËSIMIN OSE
ÇMONTIMIN E SHITJEN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutes dhe të pikave 7 e 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit dhe të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Heqjen nga armatimi dhe përdorimi i mjeteve luftarake të aviacionit të Forcave të Armatosura, të armatimit të tyre dhe të municioneve, sipas tabelave, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Mjetet luftarake të aviacionit, armatimi i tyre dhe municionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të asgjësohen ose të çmontohen dhe të shiten në formë skrap, sipas dispozitave ligjore, ndërsa pjesët, që kanë vlerë përdorimi tjetër nga ajo e përdorimit në Forcat e Armatosura, t’u nënshtrohen procedurave për administrimin dhe tjetërsimin e pronës shtetërore.

3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes të nxjerrë udhëzimin përkatës për përcaktimin e kriterëve teknike dhe të procedurave të asgjësimit, çmontimit a tjetërsimit të mjeteve luftarake të aviacionit, të armatimit të tyre dhe municioneve, të hequra nga armatimi dhe përdorimi.

4. Të ardhurat, që do të realizohen, të trajtohen sipas vendimit nr.432, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA NR.1

Nr.	Emërtimi i teknikës dhe amatimi	Njësia	Sasia	
A	AVIONËT			
1	Avionë tip Uti Mig 15	copë	8	
2	Avionë tip Uti Mig 17	“	6	
3	Avion IL-28 (bombardues)	“	1	
4	Avionë tip JAK-18	“	13	
5	Avionë tip AN-2	“	8	
	Shuma avionë	copë	36	
B	ARMATIMI NË AVIONË			
1	Top 23 mm në avion	copë	26	
2	Top 30 mm në avion	“	4	
3	Top 37 mm në avion	“	1	
	Shuma armatim në avionë	copë	31	

C	MUNICIONE AVIACIONI			
1	Municione aviacioni	Ton	931	
	Shuma ton municione	Ton	931	

TABELA NR.2

Nr.	Emërtimi i municionit	Njësia	Gjendja	Sasia ton
2054/55	Shtimje 23 mm për top av.	copë	68842	21.8
2057/1,2,PN	Shtimje 30 mm për top av.	“	87475	76.7
2058/59	Shtimje 37 mm për top av.	“	13131	18.2
2388/89	Predha reaktive të pa drejtuara S-5-1, S-5-2	“	10907	43.5
2397	Raketa të drejtuara PL-2	“	92	8.0
2360/65	Bomba aviacioni 100, 150, 250 kg	“	2600	409.7
2377/84	Djegore të aviacionit	“	11660	20.4
PN	Lëndë eksplozive+gjurmëlënës real	“	3856	4.3
	SHUMA TON MUNICONE AVIACIONE			602.6

TABELA NR.3

NR.	EMËRTIMI I MUNICIONIT	NJËSIA	GJENDJA		Propozohen për shitje, dorëzim e demontim
			F.AJRORE	KML	
2054	Shtimje 23 mm pr.therm.për top av.	copë	47364	184482	231846
2055	Shtimje 23 mm pr.bl.shp.për top av.	“	21478	38698	60176
2057/1	Shtimje 30 mm pr.therm.për top av.	“	45123	48321	93444
2057/2	Shtimje 30 mm pr.bl.shpm.për top av.	“	34719	41150	75869
PN	Shtimje 30 mm pr.prakt.për top av.	“	7633	300	7933
2058	Shtimje 37 mm pr.therm.për top av.	“	8482	23357	31839
2059	Shtimje 37 mm pr.bl.shp.për top av.	“	4649	18665	23314
2388	Predha reaktive të padrejtura S-5-1	“	5843	2762	8605
2389	Predha reaktive të padrejtura S-5-2	“	5064	16	5080
2397	Raketa të drejtuara PL-2	“	92	0	92
2360/6	Bomba aviacioni 90-100 kg	“	1407	0	1407
2361/64	Bomba aviacioni 150 kg	“	292	0	292
2362/65	Bomba aviacioni 250 kg	“	901	0	901
2370	Bomba ndriçuese aviacioni 100 kg	“	3	54	57
PN	Pirofishekë PV-1	“	40	0	40
PN	Pirofishekë PK-4-1	“	36	0	36
PN	Pirofishekë PK-4-2	“	597	0	597
PN	Pirofishekë PK-5-1	“	13	0	13
PN	Pirofishekë PK-5-2	“	25	0	25
PN	Pirofishekë PK-7-T	“	32	0	32
PN	Pirofishekë PK-16	“	18	0	18
2377	Djegore VDV	“	1127	0	1127
2378	Djegore AMA	“	6845	0	6845
2379	Djegore APUF-1	“	2470	0	2470
2380	Djegore F-2	“	252	0	252
2381	Djegore TM-24 B	“	598	0	598
2382	Djegore AVDM	“	20	0	20
2383	Djegore AV-1-DU	“	328	0	328

2384	Djegore AVDM-3521-2k	“	20	0	20
PN	Lëndë eksplozive reale	“	3486	0	3486
PN	Gjurmëlënës real	“	370	0	370
	SHUMA TON MUNICIONE	TON			931

VENDIM

Nr.671, datë 27.9.2006

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE, JOPUBLIKE “JUSTICIA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 12 e 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen e shkollës së lartë univesitare, jopublike “Justicia”, në emër të shoqërisë “Justicia”, sh.p.k. e cila do ta ushtrojë këtë veprimtari në qytetin e Tiranës.

2. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Justicia” do të jetë e nivelit universitar, me degën e vetme “Drejtësi”.

3. Shkolla e lartë universitare, jopublike, “Justicia” do të ofrojë studime në ciklin e parë të studimeve universitare, të cilat do të zgjasin 4 (katër) vite akademike. Në mbarim të studimeve ky universitet do të japë diplomë universitare “Bachelor” me titullin “Jurist”.

4. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Justicia” do të fillojë veprimtarinë në vitin akademik 2006-2007 dhe do të ketë sistemin e studimeve me kohë të plotë.

5. Ministria e Arsimit dhe Shkencës të bëjë verifikimin e plotësimit të kushteve për fillimin e procesit mësimor. Ndryshimet në adresë, stafin pedagogjik, planet dhe programet, si dhe në elementet e tjera, të miratuara, të bëhen me miratimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kryerjen e procesit të vlerësimit dhe të akreditimit të kurseve të studimit, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë në institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.23, datë 5.10.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “

me sekretare Edlira Abazi, në datë 30.6.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.28 Akti që i përket:

KËRKUES: LUAN DALIPI, përfaqësuar nga avokat Gëzim Toçila, me prokurë.
SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.
OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.868, datë 2.12.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit).

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f e 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të mësipërm:

- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin e dhënë, më ka mohuar të drejtën për t'u ankuar kundër vendimit gjyqësor që më ka deklaruar fajtor;
- Kam paraqitur rekurs në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gramsh brenda afatit ligjor, por administrata e saj e ka regjistruar në një datë tjetër, duke e korrigjuar atë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fehmi Abdiun, përfaqësuesin e kërkuesit, dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuesi është deklaruar fajtor dhe dënuar, në mungesë, me vendimin nr.8, datë 6.3.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh, me 6 (gjashtë) vjet burgim për veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje, parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal.

Me vendimin nr.18, datë 7.10.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh, është pranuar rivendosja në afat për t'u ankuar kundër vendimit të lartpërmendur.

Gjykata e Apelit Durrës, mbi ankimin e kërkuesit, me vendimin nr.7, datë 13.1.2005, ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, në datën 2.12.2005 ka vendosur mospranimin e rekursit si të paraqitur jashtë afatit ligjor.

Gjykata Kushtetuese gjatë shqyrtimit të çështjes konstatoi se kërkesa paraqet probleme kushtetuese që kanë të bëjnë me të drejtën e çdo shtetasi për të pasur akses në gjykatë, e drejtë kjo, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

Është vërtetuar se kërkuesi ka hartuar rekursin kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës në datën 10.2.2005. Ai e ka dorëzuar atë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gramsh të nesërmen, datë 11.2.2005 dhe kryetari i saj ka urdhëruar që rekursi të dërgohet për në Gjykatën e Lartë. Ajo ditë ka qenë e premte. Sekretaria e asaj gjykate ka regjistruar rekursin po atë ditë, por ka korrigjuar datën e paraqitjes së tij duke e pasqyruar si të dorëzuar ditën e shtunë, datë 12.2.2005. Më pas e ka nisur çështjen për gjykim në Gjykatën e Lartë.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr.868, datë 2.12.2005, ndonëse ka konstatuar se data e dorëzimit të ankimit ishte e korrigjuar, nuk e ka vlerësuar këtë fakt, që e detyronte ta kalonte çështjen për gjykim dhe të verifikonte gjyqësisht datën e paraqitjes së rekursit në gjykatën e rrethit gjyqësor, dhe ka vendosur mospranimin e çështjes për gjykim me arsyetimin se është paraqitur jashtë afatit ligjor.

Gjatë kontrollit kushtetues të çështjes është konstatuar se kopja e rekursit të depozituar në gjykatën e rrethit gjyqësor është e korrigjuar duke u shënuar në të data 12.2.2005. Ky fakt, që konstatohet qartë me një vështrim të zakonshëm, është vërtetuar me shpjegimet që ka dhënë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gramsh, e cila ka pranuar se data e dorëzimit të rekursit është e korrigjuar si në kopjen e depozituar ashtu edhe në regjistrin e ankimeve e rekurseve që plotësohet nga kancelaria e gjykatës, si dhe nga prokurori i rrethit, me shkresën drejtuar gjykatës së faktit.

Mbi këto prova, në Gjykatën Kushtetuese, vërtetohet se administrata e gjykatës së faktit ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 413 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me detyrimin për pasqyrimin e shënimeve të domosdoshme, për datën e paraqitjes së rekursit në kopjen e mbajtur prej saj, si dhe në regjistrin ku evidentohen ankimet e rekursit. Duke vepruar në këtë mënyrë, është vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit. Si rrjedhojë e kësaj, kërkuesit i është mohuar e drejta për akses në gjykatë. Në shqyrtimin e rastit konkret, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në shqyrtimin e çështjes, mbështetur në të dhëna të dyshimta, si data e korrigjuar e ka konsideruar ankimin e kërkuesit si të paraqitur jashtë afatit ligjor.

Sa më lart, procesi gjyqësor i zhvilluar ndaj kërkuesit në Gjykatën e Lartë është i parregullt,

sepse nuk plotëson standardet e kërkuara nga Kushtetuta dhe nga protokollit shtesë i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, që parashikojnë të drejtën për akses në gjykatë e për t'u ankuar kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë. Kjo e drejtë e rëndësishme, shkelja e së cilës dëmton rëndë të drejtat e individit, gjen pasqyrim edhe në nenin 2 të protokollit nr.7, sipas të cilit, çdo person i deklaruar fajtor për një shkelje penale nga një gjykatë, ka të drejtë të paraqesë për shqyrtim para një juridiksioni më të lartë ankimin e tij në lidhje me fajësinë ose dënimin. Këtë qëndrim Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut e ka evidentuar disa herë në praktikën e saj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.868, datë 2.12.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër pranimit të kërkesës dhe shfuqizimit të vendimit nr.868, datë 02.12.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për çështjen e kërkuarit Luan Dalipi, për këto arsye:

1. Është e vërtetë se sipas nenit 43 të Kushtetutës, kushdo ka të drejtë të ankohet në një gjykatë më të lartë kundër një vendimi gjyqësor. Por kjo e drejtë duhet të realizohet brenda afateve të përcaktuara në ligj dhe se ankimi i paraqitur jashtë këtyre afateve konsiderohet i paqenë.

2. Gjykata Kushtetuese nuk duhet të shqyrtojë faktin nëse ka ose jo korrigjime në datën e dorëzimit, në një kohë kur ky dokument nuk është goditur për falsitet. Në rrethana të tilla ai merret i mirëqenë dhe kështu del që rekursi është paraqitur jashtë afatit ligjor, prandaj me të drejtë nuk është pranuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

3. Këtë konstatim dhe vlerësim përkatës të provave e ka për detyrë dhe e ka bërë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë që ka gjykuar çështjen dhe nuk i takon Gjykatës Kushtetuese që mbi të njëjtat rrethana të bëjë vlerësim tjetër dhe të shfuqizojë vendimin.

ANËTAR
K. Peçi

MENDIMI I PAKICËS

Nuk jam dakord me qëndrimin e mbajtur nga shumica për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar si antikushtetues vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të marrë në dhomën e këshillimit, me arsyetimin se “... procesi gjyqësor i zhvilluar ndaj kërkuarit ... nuk plotëson standardet e kërkuara nga Kushtetuta dhe nga protokollit shtesë i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, që parashikon të drejtën për akses në gjykatë e për t'u ankuar kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë”. Për rrjedhojë, “... Kolegji penal, megjithëse ka vënë re se data e dorëzimit të rekursit në gjykatën e rrethit gjyqësor ka qenë e korrigjuar, nuk e ka vlerësuar këtë fakt, që e detyronte atë ta kalonte çështjen për gjykim dhe të verifikonte gjyqësisht datën e paraqitjes së rekursit në gjykatën e rrethit gjyqësor.

Për çështjen në shqyrtim, data e paraqitjes së rekursit në Gjykatën e Lartë është një çështje fakti, që është vlerësuar nga Kolegji Penal në dhomën e këshillimit. Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese se data e dorëzimit të rekursit ka qenë e korrigjuar nuk mendoj se përbën argument ligjor

dhe aq më tepër kushtetues për të konkluduar se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor. Konkluzionin se kërkuessit i është cenuar e drejta për akses në gjykatë, shumica e ka nxjerrë duke u bazuar tek dyshimi dhe jo në provat shkresore. Në mënyrën se si e ka zgjidhur çështjen Gjykata Kushtetuese, mendoj se ka marrë atributet e një gjykate themeli, duke i dhënë provave një kuptim të ndryshëm nga ajo që kanë pranuar gjykatat e zakonshme.

Arsyeja e dytë, që sipas mendimit tim, duhej rrëzuar kërkesa, lidhet me qëndrimin e mbajtur ndaj vendimeve të marra nga Kolegjet e Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit. Për këtë arsye, po i rikthehem edhe një herë qëndrimin në pakicë të mbajtur në disa çështje të tjera, ku kam argumentuar se mënyra e vlerësimit të shkaqeve të paraqitura në rekurs dhe të shqyrtuara në dhomën e këshillimit nga Gjykata e Lartë, nuk mendoj se përbën jurisprudencë kushtetuese në kuptim të cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Kalimi ose jo i një çështjeje në seancë gjyqësore është më tepër një problem kompetence, që i është lënë në vlerësim organit të caktuar me ligj për ushtrimin e kësaj të drejte, pra Kolegjeve të Gjykatës së Lartë. Shqyrtimi i çështjeve në dhomën e këshillimit dhe marrja e një vendimi mospranimi për rastet kur nuk janë shkaqet ligjore për kalimin në seancë, nuk lidhet me cenimin e së drejtës për akses në gjykatë, përse kohë që këtë të drejtë Kolegjet e Gjykatës së Lartë e kanë të parashikuar me ligj. Vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese, si shkelje e së drejtës për proces të rregullt ligjor, e rasteve të moskalimit të një çështjeje në seancë gjyqësore, ndërkohë që në tërësinë e rasteve të tjera këto kërkesa nuk janë konsideruar si çështje të jurisprudencës kushtetuese, krijon edhe luhatje në qëndrimet e mbajtura prej saj.

ANËTAR
S. Sadushi

UDHËZIM
Nr.6, datë 5.10.2006

PËR PROCEDURAT DHE KRITERET E AKREDITIMIT TË VËZHguesVE TË
SUBJEKTEVE ZGJEDHORE NË KZQV, KQV DHE VNV, NGA KZQV-JA, PËR
ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 18 pika 2, 3, 4, 5 dhe 6, nenit 19 dhe nenit 29 pika 1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe kriteret e akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në Komisionin e Zgjedhjeve për Qeverisjen Vendore (KZQV), Komisionin e Qendrës së Votimit (KQV) dhe në Vendin e Numërimit të Votave (VNV), nga Komisioni i Zgjedhjeve për Qeverisjen Vendore për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore.

Neni 2
E drejta për të caktuar vëzhgues

1. Çdo parti politike/koalicion i regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor, ka të drejtë të caktojë

nga një vëzhgues në KZQV, KQV dhe në VNV, pas regjistrimit të një kandidati për njësinë zgjedhore përkatëse ose pasi ka paraqitur listë shumëmemërore.

2. Për partitë politike që paraqiten në zgjedhje si koalicion, të drejtën për të caktuar vëzhgues e ka vetëm koalicioni.

3. Kandidatët e partive politike dhe koalicioneve nuk kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues.

4. Kandidatët e pavarur në zonat e tyre përkatëse kanë të drejtë të caktojnë nga një vëzhgues në KZQV, KQV dhe në VNV.

Neni 3

Akreditimi i vëzhguesve

1. KZQV-ja bën akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore të parashikuara në nenin 2 të këtij udhëzimi, vetëm për ambientet zgjedhore që përfshihen në territorin e njësisë së qeverisjes vendore.

2. Çdo subjekt zgjedhor mund të kërkojë akreditimin vetëm të një vëzhguesi në KZQV, KQV dhe VNV. Vëzhguesi i subjektit zgjedhor, i akredituar në KZQV, mund të vëzhgojë procesin zgjedhor dhe në qendrat e votimit të kësaj njësie zgjedhore.

3. Akreditimi i vëzhguesit në qendrën e votimit mund të përfshijë një ose më shumë QV. Në asnjë rast, një parti politike, koalicion ose kandidat i pavarur, nuk mund të ketë më shumë se një vëzhgues të pranishëm në një qendër votimi.

4. Akreditimi i vëzhguesit në vendin e numërimit të votave nuk mund të përfshijë më shumë se një VNV. Në çdo rast një subjekt zgjedhor nuk mund të ketë më shumë se një vëzhgues në VNV njëkohësisht. Vëzhguesi i KZQV-së mund të jetë vëzhgues dhe në VNV.

Neni 4

Kushtet për të qenë vëzhgues

Vëzhgues mund të jetë çdo shtetas shqiptar që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) të ketë të drejtën e votës;

b) të ketë zotësi për të vepruar.

Neni 5

Kërkesa për të caktuar vëzhgues

1. Kërkesa e subjekteve zgjedhore e parashikuar në nenin 2 të këtij udhëzimi, për akreditimin e vëzhguesve në KZQV, KQV dhe VNV, i paraqitet KZQV-së përkatëse.

2. Kërkesa duhet të ketë bashkëngjitur:

a) listën e vëzhguesve që kërkohet të akreditohen pranë KZQV/KQV/VNV të nënshkruar në çdo faqe nga kryetari i partisë/përfaqësuesi i koalicionit/kandidati i pavarur, ose personi i autorizuar prej tyre, sipas modelit të përcaktuar në lidhjen nr. 1 bashkëngjitur këtij udhëzimi;

b) vërtetimin që partia/koalicioni është i regjistruar në KQZ.

Neni 6

Personat që bëjnë kërkesën për akreditimin e vëzhguesve

Kërkesa për akreditimin e vëzhguesve dhe dokumentacioni përkatës mund të paraqiten nga personat e autorizuar nga organi drejtues i partisë/përfaqësuesi i koalicionit/kandidati i pavarur. Akti i autorizimit depozitohet në KZQV.

Neni 7

Afatet e kërkesave për akreditim

1. Kërkesat e subjekteve zgjedhore për akreditimin e vëzhguesve i paraqiten KZQV-së jo më herët se 45 ditë dhe jo më vonë se 15 ditë para datës së zgjedhjeve.

2. KZQV, brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës, bën verifikim paraprak të dokumentacionit përkatës dhe në rast të mungesave, në përmbajtje ose në formë, në dokumentacion, vendos kthimin e tyre për plotësim.

3. Dokumentacioni i plotësuar ridepozitohet brenda 24 orëve nga shpallja e vendimit të kthimit. Verifikimi i dytë i dokumentacionit bëhet brenda 24 orëve nga ridepozitimi i tij.

4. KZQV-ja merr vendim për miratimin ose jo të kërkesave jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e tyre.

5. Kundër vendimit të KZQV-së për refuzimit të kërkesës për akreditim mund të bëhet ankim sipas nenit 146 pika 2 të Kodit Zgjedhor.

Neni 8

Autorizimi dhe mandati i vëzhguesve

1. Vëzhguesit e miratuar me vendim nga KZQV-ja përkatëse, regjistrohen nga sekretari i KZQV-së në librin e protokollit të KZQV-së dhe pajisen nga ai me autorizimin përkatës, sipas modelit të përcaktuar në lidhjen nr.2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Vëzhguesit mund të kryejnë vëzhgime vetëm në ambientet zgjedhore të përcaktuara në autorizimin e KZQV-së.

3. Në autorizimin e lëshuar nga KZQV-ja duhet të përcaktohet:

a) emri, mbiemri i vëzhguesit;

b) emri i subjektit zgjedhor që e cakton si vëzhgues;

c) qendra e votimit/njësine e qeverisjes vendore /Vendi i Numërimit të Votave.

4. Autorizimi mban vulën e KZQV-së dhe është i firmosur nga kryetari dhe nënkryetari i KZQV-së.

Neni 9

Të drejtat dhe detyrimet e vëzhguesve

1. Vëzhguesit kanë këto të drejta:

a) të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve;

b) të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërejnë;

c) të shohin ose të këqyrin dokumentacionin ose materialet e procesit zgjedhor.

2. Vëzhguesit kanë këto detyra:

a) të respektojnë kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe udhëzimet e KQZ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve, si dhe vendimet dhe urdhërimet e KZQV-së ku është akredituar;

b) të mos bëjnë propagandë për asnjë kandidat, parti ose koalicion në ambientet zgjedhore;

c) të paraqiten para KZQV-së, KQV-së dhe VNV me autorizimin e lëshuar nga KZQV-ja, të shoqëruar me një nga dokumentet e identifikimit personal siç janë: pasaportë, certifikatë personale me fotografi ose letërnjoftim.

ç) të mos mbajnë shenja dalluese që shërbejnë si propagandë ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësit;

d) të mos dhunojnë të drejtën e votuesit për të votuar në fshehtësi dhe të mos pengojnë procesin e votimit dhe numërimit të votave;

e) të respektojnë rregullat e etikës në marrëdhëniet me Komisionerët Zgjedhorë dhe vëzhguesit e tjerë, të mos komentojnë me zë dhe të mos debatojnë lidhur me zhvillimin e procesit të votimit.

Neni 10

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çlirim Gjata

Flamur Çato

Dëshira Subashi

Klement Zguri

Arben Ristani

Fatmir Kumbaro

Dodë Prenga

Kryetar

Zv/Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

LISTA E VËZHguesve

SUBJEKTI ZGJEDHOR _____

Nr.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	DATËLINDJA	NR.I DOK. ID.	KZQV/VNV/QENDRA (T) E VOTIMIT QË PËRFSHIN AKREDITIMI
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						
14						
15						
16						
17						
18						
19						
20						
21						
22						
23						
24						
25						

DATE _____.____.2006

NËNSHKRIMI

VULA

KZQV XXXXXXXXXXXX

AUTORIZIM

PËR VËZHguesIT PËR SUBJEKTET ZGJEDHORE

EMRI MBIEMRI: _____

SUBJEKTI ZGJEDHOR: _____

AKREDITUAR VËZHgues NË _____

NR: _____

KZQV/KQV/VNV

KRYETARI

N/KRYETARI

VULA E KZQV-së



DT _____



Udhëzimi
Për procedurat dhe kriteret e akreditimit të vëzhguesve
të subjekteve zgjedhore në KZQV, KQV dhe VNV, nga
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore

Data

Ky autorizim duhet të shoqërohet në çdo rast me dokument identifikimi me fotografi

Të drejtat :

- 1) të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve;
- 2) të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërejnë;
- 3) të shohin ose të këqyrin dokumentacionin ose materialet e procesit zgjedhor.

Detyrat:

- 1) të respektojnë kërkesat e këtij Kodi dhe udhëzimet e KQZ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve, si dhe vendimet dhe urdhërimet e KZQV-së ku është akredituar.
- 2) të mos bëjnë propagandë për asnjë kandidat, parti ose koalicion në qendrat e votimit ose në vende të tjera të ndaluara sipas Kodit Zgjedhor;
- 3) të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin e lëshuar nga KZQV-ja, të shoqëruar me një nga dokumentat e identifikimit personal siç janë : pasaportë, certifikatë personale me fotografi ose letër njoftimi.
- 4) të mos mbajnë shenja dalluese që shërbejnë si propagandë ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësit;
- 5) të mos dhunojnë të drejtën e votuesit për të votuar në fshthtësi dhe të mos pengojnë procesin e votimit dhe numërimit të votave;
- 6) të respektojnë rregullat e etikës në marrëdhëniet me Komisionin e Zgjedhjeve dhe vëzhguesit e tjerë, të mos komentojnë me zë dhe të mos debatojnë lidhur me zhvillimin e procesit të votimit;

Nr.509, datë 29.9.2006

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR
“TV KRUJA”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” miratuar me Vendimin nr.162 të KKRT-së, të vendimeve nr.439, datë 21.3.2006 dhe nr.474, datë 29.6.2006 të KKRT-së, të nenit 112, pika 2/a të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.024/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, personin fizik z. Lulëzim Spata për televizionin “TV Kruja”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 3.1.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Ledi Bianku**

**VENDIM
Nr.510, datë 29.9.2006**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR
“KRISTAL +”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” miratuar me Vendimin nr. 162 të KKRT-së, të vendimit nr.481, datë 29.6.2006 të KKRT-së, të nenit 112, pika 2/a të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.052/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, personin fizik z. Thanas Kote për televizionin “TV Kristal +”.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 29.08.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Ledi Bianku**

**VENDIM
Nr.512, datë 29.9.2006**

**PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTIT TELEVIZIV KABLLOR
PRIVAT “TEPELENA SAT”**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, vendimit të KKRT-së nr.428, datë 21.3.2006, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004 ndryshuar me vendimin nr.503, datë 17.7.2006, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit për televizionin kabllor privat “Tepelena Sat”, me nr. licence 040/RTVK në qytetin e Ersekës.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për veprime të mëtejshme.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Ledi Bianku**

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
5. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006(Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDERTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000- 2006).....	1000
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 16.10.2006
Doli nga shtypi më 18.10.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë